

**AKT THEMELIMI I SHOQERISE**  
**ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“BONDES Holding” Sh.p.k.**

Sot me date 22 gusht 2022, une i nenshkruari Z. Dorian Sadiku, shtetas shqiptarë, i lindur në Shkodër më 20.06.1979, mbajtës i pasaportës me nr: BF5378227 dhe nr personal H90620115D, kam vendosur te nënshkruaj Aktin e Themelimit te meposhtem te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar (me poshte “Shoqeria”), aktiviteti i se ciles rregullohet nga legjislacioni shqiptar ne fuqi dhe Statuti i saj, i cili eshte pjese perberese e ketij akti.

**Neni 1 - Emertimi**

Emërtimi i Shoqërisë është “BONDES Holding” Sh.p.k.

**Neni 2 - Selia**

Selia e Shoqërisë është Rruga “Emin Duraku”, Pall: Binjaket, nr: 5, njësia bashkiake nr: 5, Tiranë, Shqipëri.

**Neni 3 - Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë pa afat.

**Neni 4 – Objekti i shoqerise**

4.1 Shoqeria ka per objekt kryerjen e aktiviteve tregtare ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi.

4.1 Ne menyre me specifike, Shoqeria do te kryeje aktivitet tregtar:

- Themelimi dhe krijimi i shoqerive dhe siper marrjeve shqiptare dhe te huaja si dhe pjesemarrja ne to, administrimi dhe drejtimi i shoqerive tregtare dhe siper marrjeve vendase apo te huaja; Blerja apo disponimi mbi pjesemarrjen e kapital ne korporata, partneritete apo shoqeri e sindikata me objekte aktiviteti te ndryshme, blerja dhe shitja e aksioneve dhe kuotave apo pjesemarrje te tjera ne siper marrje dhe shoqeri, brenda kufijve te lejuar nga legjislacioni i aplikueshem; Blerja, barresimi, hipotekimi apo transferimi i pasurive te paluajtshme dhe atyre te luajtshme si dhe titujve; Pjesemarrje ne shoqeri me objekte aktiviteti ne fushen e mkesise dhe farmaceutikes, ndertimit, investime energjitike, imobiliare, ne lojra fati etj; Gjithashtu, ne perputhje me legjislacionin shqiptar, shoqeria mund te kryeje dhe te realizoje çdo aktivitet qe lidhet direkt apo indirekt, eshte si rrjedhim apo ka te beje me objektivat e



renditura me siper. Per te arritur qellimin e mesiperm shoqeria mund te ndermarre veprime me pasurite e luajtshme apo te paluajtshme dhe cdo aktivitet tregtar, financiar, per dhenie me qira apo hipotekim qe mund te konsiderohet i dobishem apo i nevojshem ne menyre qe te arrihet objektivi i shoqerise.

#### **Neni 5 – Kapitali themeltar**

- 5.1 Kapitali themeltar i shoqerise eshte 30,000 euro (tridhjet mije Euro).
- 5.2. Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 1 (një) kuot, me vlere nominale 30,000 euro (tridhjet mijë Euro).

#### **Neni 6 - Kontributet**

6.1 Kontributi ne kapitalin e shoqërisë është ofruar si me poshtë:

-Ortaku Z. Dorian Sadiku, shtetas shqiptarë, i lindur në Shkodër më 20.06.1979, mbajtës i pasaportës me nr: BF5378227 dhe nr personal H90620115D, ka ofruar një kontribut në para të barabartë me 30,000 euro (tridhjet mijë euro).

6.2 Sipas kontributeve te mësipërme:

-Ortakut Z. Dorian Sadiku i përket 1 (një) kuote, qe i korrespondon me 100% (njëqind përqind) te kapitalit te Shoqërisë.

#### **Neni 7 – Transferimi i kuotave**

Kuotat i transferohen te treteve sipas parashikimeve te Statutit.

#### **Neni 8 – Administrimi**

8.1 Me kete akt emerohet 1 (nje) Administrator i Shoqerise personi si me poshte:

- Z. Dorian Sadiku, shtetas shqiptarë, i lindur në Shkodër më 20.06.1979, mbajtës i pasaportës me nr: BF5378227 dhe nr personal H90620115D.

8.2 Administratori do te ushtroje te gjitha kompetencat e administrimit te zakonshem, ne perputhje me parashikimet e nenit 95 te ligjit nr. 9901, date 14 prill 2008 "Per tregtaret dhe Shoqerite tregtare" dhe nenit 14 te Statutit.



8.3 Administratorit i jepet te gjitha kompetencat e nevojshme per te kryer te gjitha formalitetet per permbushjen e detyrimeve te parashikuara per themelimin e Shoqerise sipas legjislacionit ne fuqi. Per kete qellim, Administratoret, mund t'u drejtohen per ndihme te treteve ose konsulenteve te cileve mund te delegojne ne teresi ose pjeserisht kryrjen e aktivitetit te siperpermendur.

8.4 Administratori eshte gjithashtu i autorizuar te veproje ne emer te Shoqerise per formim e deri ne regjistrimin e saj prane Qendres Kombetare te Regjistrimit. Ai eshte gjithashtu i autorizuar, te firmosi te gjitha aktet dhe te marre persiper detyrime ne emer te Shoqerise qe rrjedhin prej momentit te regjistrimit te saj si edhe ka te drejte t'i delegoje kompetencat e tyre personave te tjere.

#### **Neni 9– Gjuha**

9.1 Ky Akt Themelimi eshte hartuar ne 3 (tre) kopje ne gjuhen shqipe.

#### **ORTAKU I VETEM I SHOQERISE**

**Z. Dorian Sadiku**

Dorian Sadiku  
